



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:200432
Datë: 31.10.2024
Numri i dokumentit: 06379674

C.nr.4802/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen kontestimore të paditësit G.J nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av.L.B nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar me vlerë të kontestit 611.00 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 30.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit G.J nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore 01.09.2021 – 20.06.2022, për 111 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t'ia paguaj paditëses shumën prej 222.00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës, duke llogaritur 50 % të pagës bazë, t'ia paguaj paditësit shumën prej 229.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 451.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 16.07.2024, si datë e paraqitjes së kërkesës te e paditura, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. II. Refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, e kërkuar më tepër se shuma e aprovuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shumë prej 160.00 euro, për periudhën 25 Janar 2021 – 10 Qershor 2021, në emër të kompensimit për ushqimin ditor.

III.DETYROHET e paditura që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës paditëses në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuares së tij, më datë 16.07.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, dhe shpërblimit jubilar, në vlerë prej 611.00 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është e punësuar te e paditura, në Shkollen e Mesme Ekonomike (në vijim:SHME) “Marin Barleti”, në Gjilan, në cilësinë e mësime dhënësit. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim: KKAK) të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 ka shtuar se paditëses i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore 25.01.2021 – 20.06.2022, dhe shpërblimi jubilar prej 50 % page bazë për 10 vite përvojë pune. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën t’ia kompensojë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar në shumat e aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro për përpilim të padisë dhe 20.00 euro për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtuar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura dhe ka gjithsej 12 vite përvojë pune në institucione arsimore (fakt i vërtetuar nga vërtetimi i dt.18.09.2023 lëshuar nga SHME “Marin Barleti”, në Gjilan).

Nuk është kontestuese se për periudhën kohore 25.01.2020 – 10.06.2021 ka 80 ditë të pranisë në punë, kurse për periudhën kohore 01.09.2021 – 20.06.2022 ka gjithsej 111 ditë, gjithësej 191 ditë të pranisë në punë (fakt i vërtetuar nga vërtetimi si më lartë); ndërsa paga bazë e të njëjtit është 459.00 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit dhe jo themelësia e kërkesëpadisë e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 7 se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”; paragrafi 8, pika 8.1 se “Punëtorët (anëtarë të SBASHKUT-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, ashtu që për 10 vite të përvojës së punës i kompensohet 50 % të pagës bazë.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 25.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 20.06.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e vërtetoi nga fakti se për shpenzimet e ushqimit nga 2 euro në ditë, për 111 ditë në total, arrijnë vlerën prej 222.00 euro dhe lartësinë e kërkesëpadisë për 10 vite përvojë pune, duke llogaritur 50 % të pagës bazë, arrin vlerën prej 229.50 euro.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, si dhe kërkesa për shpërblimin jubilar, gjykata gjen se është arritur gjatë kohës sa i punësuar, këtu paditësi ka mbushur përvojën prej 10 vite kur KKAK ka qenë në fuqi (gjatë vitit 2021), pra vitin e 10 jubilar.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi ka gjetur se kërkesa e paditëses për kompensimin e ushqimit ditor është pjesërisht e përfshirë në parashkrim.

Në nenin 87 të LP-së, është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, prandaj gjykata duke marrë parasysh faktin se kërkesa e paditësit është kërkesë monetare nga marrëdhënia e punës dhe e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjeti se për 3 vite mbrapa nga data e inicimit të padisë në këtë gjykatë (11.07.2024), pjesa tjetër e kërkesës së paditësit deri më datë 11.07.2021 është e parashkruar.

Prandaj, bazuar në nenin 87 të LP-së, kërkesa e paditësit deri më datë 11.07.2021 është e parashkruar.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi se KKAK nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, gjykata e vlerëson të pabazuar, pasi e njëjta është e lidhur në nivel vendi dhe bazuar në nenin 2 të saj është e zbatueshme për të gjithë të punësuarit dhe punëdhënësit, që përfshin këtu edhe të paditurën. Nga kjo, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të cilat derivojnë nga kontrata kolektive. Shfrytëzimin e mjeteve juridike në procedurë administrative para paraqitjes së padisë, gjykata e vlerëson pretendim të pabazuar, ngase e drejta e punës si kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare e me ligj, për kërkesat në të holla që rrjedhin nga marrëdhënia e punës nuk është e nevojshme që paraprakisht i punësuarit t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë. Fakti se nga kontrata e vitit 2021 është shkëputur MASHT, gjykata vlerëson se nuk është fakt relevant për këtë çështje kontestuese, pasi të njëjtat kontrata prodhojnë efekt juridik deri në momentin e shkëputjes dhe shkëputja nuk ka fuqi retroaktive, ashtu që kërkesat e palëve zbatohen për aq sa kërkohen kur kontratat kanë qenë në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.4802/24, datë 30.10.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.